

LULJETA DANAJ

LODER  
E  
DASHURISE

BLIOTEKA

81H-1

820

*poezi*

81H-1  
820

Luljeta  
Danaj

Lodër  
e  
dashurisë

poezi

Tato



SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

## RRETH DIELLIT

Rrotullohet Toka  
dhe Jupiteri i madh, të gjithë planetët e plot  
të tjerë

dhe ne të dy.

Sa pak zgjat rrotullimi ynë,

sa pak.

Por prapë vetëm ne të dy

bëmë kaq zhurmë

dhe ecim pa orbitë, zhvendosemi çrregullt

dhe bëjmë ca gjëra që s'i bën dot

Vetëm ne të dy, jetëshkurtërit,

bëjmë kaq zhurmë rreth Diellit

dhe guxojmë për të gjitha.

## LODHJA NG.

Më lodhi e  
më lodhi të  
Thashë se f  
M'u bë ënd  
Më lodhi e  
më lodhi të

Si të shpëto  
Si të më bër  
Vendosa ta  
Në gur.  
Mbiu...



## A E BUKURA

bukura,  
rë ditën.

ija.  
ërr.

bukura,  
rë natën.

ija?  
nte dora ta vrisja?!  
mbillja,

## PËR LULET

Sonte më çuditi termometri  
me temperaturën normale që tregonte.  
Sa digjesha!

Sonte më çuditi nëna ime  
që s'kuptoi asgjë po më pyeti për mësimet.  
Digjesha.

Sonte më çuditi shoqja ime  
Si nuk më kuptoi as ajo?!  
Kurse unë digjesha.

Këputa një lule.  
I mora erë.  
Lulja u tha.

Vetëm lulja e ndjeu që digjesha.

## VRAPOJ SHUMË

Vrapoj shumë  
duke bërë kujdes mos t'i kaloj shumë stinët,  
mos t'i zemëroj,  
ta ruaj shoqërinë me to.

Jam shumë vraparake  
Dielli këtë e vëren  
kur shikon se para së bukurës  
qëndroj tepër gjatë.

Jam shumë vraparake,  
nëna këtë e di  
sepse tek ajo qëndroj pa dashur më të iki.

Jam shumë vraparake.  
Gjumi i vëllait,  
që unë të vrapoj edhe më,  
zgjat shumë, sa unë s'mund të iki pa u zgjuar  
vëllai.

Vrapoj shumë,  
se dua të rri sa më shumë  
me ata që i dua.



## KËRKOJ NJË NJERI

Kërkoj një njeri që të jetë i fortë,  
sa fjala i bukur.

Kërkoj një njeri, që, kur t'i them: të gjeta,  
ai të më thotë,

ose

kam dhe shokë të tjerë si veten,

ose,

hajt, të bëjmë shokët si veten,

ose,

hajt, të bëjmë veten si njeriun që kërkojmë.

## TË JESH FËMIJË

Duke qenë fëmijë,  
tërhoqa rreth vetes  
shumë njerëz seriozë.

Duke qenë fëmijë,  
unë nuk e zgjedh atë që them,  
por them atë që ndiej.

Duke qenë fëmijë,  
njerëzit s'e kanë të lehtë  
të flasin me mua

por sidomos s'e kanë të lehtë  
të më përgjigjen.

SONTE, UNË DHE HËNA

U ndesha sy më sy me hënën.  
Ajo sonte qesh e tëra.

Unë besoj në dashurinë e diellit e të hënës.

Hënë moj, kot më mburresh mua,  
shoku im sytë m'i bëri hënor'.

Hënë moj, e kupton që jemi njësoj?

## JAM NË DASHURI ME DIELLIN

Jam në dashuri me diellin,  
Jam në dashuri me zemrën e zjarrtë.  
Por,  
megjithëse është diell,  
ndonjëherë,  
ikën dielli, ftohtë pas reve.



## MJEGULL

Mëngjesi ish mjegull e dendur  
të dy kaluam fare pranë  
njëri-tjetrit s'e pamë.

Mesdita na nxori prapë përballë  
dhe përsëri mëri mbajmë.  
Si të mund mjegullën të kthej  
që fajin t'ia hedh prap' asaj?

## D U E L

Brenda meje,  
kur bie fjala për ty,  
mendja dhe zemra  
më grinden gjatë.


Dhe mëri akoma më gjatë  
njëra-tjetrës i mbajnë  
pasi flasin për ty.

## LODËR E DASHURISË

Po vjen dielli! Po vjen dielli!  
Të lutem, nënë,  
këtë lodër të bukur  
ma bli, ma bli!  
Të lutem, të lutem.

Po diellin e fëmijërisë  
lodrën time s'e bëra dot.

Dhe kur më erdhi  
prilli i nëntëmbëdhjetë  
me një vesë të bukur si shi,  
me një shi të bukur si vesë  
arrita të los me diellin.



ME LULESHQERRË

Heq një petale. Më do.  
Heq dhe një tjetër. S'më do.  
Më do. S'më do. Më do. S'më do.  
S'të do, më thotë e fundit petale.

Paska dhe lule gënjeshtare.



MALLI YT

Një tufë e madhe pëllumbash  
u ndal mbi mua dhe më mbyti.  
Ty të kish marrë malli për mua.

## MARSHI I CIGANES SË RE

Jam një vajzë flokëpakrehur,  
gjithmonë me fustane të gjera,  
gjithë ditën  
e shkrij në këngë e valle.

Këndoju me ciganët në gjuhën time  
flas si di unë, arabisht,  
u them gënjeshtër të bukura,  
më thonë gënjeshtër të bukura.

Më jepni pak arrë të bëj buzët  
dhe unë do të jem perëndeshë,  
më jepni një djalë që di të dojë  
dhe unë do të jem perëndeshë.

Dhe shumë të më jepni,  
dhe pak të më jepni,  
unë prapë do të jem  
perëndeshë.

## Ç'NGRE NJERIU

Ngrihet një mall, më lodh në zemër.  
Është ai.

E ndiej,  
i ngrohtë si dielli.

Nuk flet,  
nuk flet si dielli.

Ngrihet një mall, më lodh në zemër.  
Më lodh aq ëmbël.



## KOHA PAS DASHURISË

U zemëruam  
dhe unë thashë  
se deri në mbrëmje e prisja të pajtohej.  
Në mbrëmje s'u duk.  
Thashë se do e prisja deri të nesërmen.  
Të nesërmen s'e gjeta.  
Pastaj larg,  
edhe më larg se fjala larg  
ia shtyva kufirin pritjes.

Dikur veten hapa në pritje  
dhe e pyeta,  
ajo më tha  
se pritja kish qenë aq e gjatë,  
sa tashmë kam harruar çfarë pres.

Tani u binda  
se e mbarova punën e detyruar,  
të fshij atë që shkoi,  
por sepse ngacmohem  
kur vjen stina e re:  
unë i thërras me emrin e saj,  
ajo s'më përgjigjet.  
Unë i thërras me emrin e tij,  
ajo atëherë përgjigjet.

Tregime

## MËSUESI MË POROSITI

Mësuesi im  
më la një porosi të artë,  
kur më nisi:

Kur të shkosh tek njerëzit,  
dërgoju punën tënde  
që të masin sa i do.



NJË SHOQE MË THOTË...

. . .vala ish e lumtur  
se bregun vërtet s'e arriti,  
por bregun e pa.

Nuk mundem të bëj si vala.  
Është më e rëndë të mos arrish bregun  
pasi e ke parë.

TRITOMI I MITHASIS

PËR NËNËN DHE BABANË

Prindërit e mi të bukur punëtorë,  
do të bëhem e urtë sa të mos më njihni,  
si këmbim për fëmijërinë dhe rininë e sertë.  
Do të bëhem e urtë.

Prisni sa të mbaroj këngën për ju.  
Ta mbaroj deri tek horizonti.

## NË REPARTIN E MONTIMIT

Këtu, në repartin e montimit,  
hyra unë.

Dhe vargjet e mia,  
që kishin hënë të bardhë, diell të kuq,  
hynë

dhe panë gjëra që...

Sa vargje m'u çmontuan këtu!  
Dhe ikën me turp  
s'di se ku.



## NË KISHËN E APOLONISË

S'e kisha parë Jezu Krishtin asnjëherë.  
Dija vetëm që para tij  
duhej të gjunjëzoheshe,  
të luteshe të të faleshin mëkatet.

E pashë.  
Para meje qëndronte i gjunjëzuar  
në lutje për t'ia falur mëkatet.



## PAJTIMI I TË DASHURUARVE

Kur zemërohen të dashuruarit  
besojnë ndarjen  
ashtu  
të vërtetë dhe të pakthyeshme.

Po se si gjenden ballë njëri-tjetrit  
ashtu  
të ngarkuar.  
Të dashuruarit s'shkarkohen në fjalën: më fal.  
Të dashuruarit shkarkohen në fjalën: erdha.

KËNGË TË DHËNA BASHKË ME  
PROVIMET E MATURES

Prit pak këtu, këngë e kaltër,  
Se ç'qenkan ca këngë diku tutje,  
po shkoj t'i këndoj.

Në janë të vërteta,  
desha t'i provoj.  
M'i dëgjoi një njeri i vogël.  
M'i shau.  
Të vërteta qenkan, i kuptova.

## B U B I

Netëve të frikshme si përrallat me hajdutë,  
e lehura jote kafshon frikën time.  
Mëngjesi na gjen: ty të ngjirur  
mua me dëshirën të të lidh shallin tim.

Dhe doja një këngë të shkruaja për ty,  
shoku im i mirë i netëve me frikë.  
Por një mbrëmje... Kthehesha vonë,  
doja e pazhurmë të futesha në shtëpi,  
ti më pe, më njohe dhe lehe fort,  
si të isha e huaj. Babai, nëna dolën.

Ah, Bubi ç'më bëre!  
Po unë i këndoj besnikërisë sate.



## SY FËMIJE

Më ranë sytë në sytë e një fëmije.  
M'i kapën sytë sytë e një fëmije.

Syve të tij s'arrita  
asgjë t'u fshihja,  
s'arrita.  
Mbeta zbuluar.

Më kapën sytë e një fëmije.



KALOJMË SHUMË AFËR,  
JEMI SHUMË LARG

Jemi shumë afër.  
Më duhet të eci vetëm në një rrugë  
që të vij tek ti.  
Kalojmë aq afër  
sa, po t'i them shoqes që kam në krah diçka,  
ti e dëgjon,  
kaq afër kalojmë.

Largohemi pastaj,  
Unë krijoj  
që të të dal ty përballë.

Jemi shumë larg,  
sa në mes largësisë sonë  
mund të futen shumë dashuri.

Jemi shumë larg në mendimin tonë  
e zemra i shkon pas mendimit.

## NË PARK

Mbi stolat bosh të parkut  
bie xhelozia e vjeshtës  
në formë gjethesh të verdha.  
Më pas dimri do të zhdukë çdo gjurmë.

Por pranvera përsëri do të vijë.  
Sa mirë!



## PEIZAZH I NJË BUZËMBRËMJEJE

Në qiell të varura  
copa resh blu e të zeza  
lëvizin të shqetësuara.  
Lëvizin mendimet e mia pas dritares.

Amebat e reve  
lëvizin papushim.  
Herë-herë mes tyre del hëna e ngrënë,  
si pikëpyetje në mendim.

Figurat lëvizin. Ikin. Kthehen.  
Vozitje të vështirë  
bën hëna e bardhë.  
Kjo lojë e trazuar  
avitet të gjejë llojin e saj.



## U NISËN ZOGJTË

Po nisen miqtë e mi.  
Me zërin e ndarjes më thonë:  
Mirupafshim! Mirupafshim!

Violonçeli i fqinjit gëzon.  
Po ikin miqtë e mi.

Fqinji violonçelin po bën zog.

## TELEFONI NË VJESHTË

Ti ngre receptorin.  
Alo, alo kush jeni?  
Askush s'përgjigjet.  
Kush të jetë?  
Alo, alo kush jeni?

Janë zogjtë në stacionin e fundit.

Ndaj mos u çuditni  
kur përgjigje s'do të merrni  
nga telefoni në vjeshtë.

Janë zogjtë.

## TË PRESESH

Çdokush mund ta realizojë pritjen,  
por jeta t'i quan gabime ca pritje.

Edhe duke pritur  
mund të bësh diçka  
që pritja të jetë pritje,  
por jo ndalesë në jetë.

## NJOHA NJË NJERI TË NGADALTË

Njoha një njeri të ngadaltë.

Provova ta mësoja  
që të ecte.

Mësimi im fitoi,  
fitoi ai, njeriu, që provoi të ecte.

Sa bukur më qeshte.  
Sa bukur  
të ecësh!

Dhe unë po nxirrja mësimin e dytë  
për atë dhe për vete,

Të ecësh sjellka kaq jetë  
Po sikur të vraposh?



## BORA NË FUSHË

Po bie borë. E bukur qenka bora,  
po borës s'po ia besokam dot sekretin  
atë sekret që shiut ia jap pa ngurim.  
Me borën mund të lozësh  
kurse me shiun unë intimitoj.

Dhe nuk po hesht,  
se nuk kam asnjë kujtim nga bora,  
që të soditnim bashkë borën  
e të krijonim heshtjen në borë,  
heshtjen emërmadhe të kujtimit.

PËR ATË QË IKU

Aj iku nga unë,  
në ditën time më të keqe  
duke më lënë vetëm.

E dënova atë  
duke mos thurur asnjë varg.

UNË AKUZOJ ATË QË DUA

Unë akuzoj atë që dua,  
për gjithë bisedat boshe  
që bën poshtë e lart  
ndërkohë që unë  
kam zbuluar sekretin e fjalës  
dhe s'mund t'ua tregoj të tjerëve  
pa e dëgjuar ai i pari.

## LULET E ZJARRIT

Kur më dhurove lule zjarri,  
m'u duk  
se zjarri kish ngrirë  
dhe ish bërë lule  
siç bëhet uji kristal.

Kur ti vonon,  
s'guxoj të marrë frymë pranë luleve.  
Më duket se zjarri i ngrirë  
do shkrijë në flakë.



## NË KABINËN TELEFONIKE

Sot në lajmëthirrje  
më kapi e qeshura  
dhe s'thashë dot një fjalë.  
Treminutëshi kaloi.

Përderisa ka lajmëthirrje për bisedë,  
lajmëthirrje për të qeshurën duhet të ketë.

ÇAST MEDIOKËR NGA RRUGA  
E ELBASANIT

Vajza që ecin me shoqe përkrahu  
dhe djem që rrinë ulur trotuarit e shikojnë.

Por vajzat që ecin përkrahu me shoqe  
të gjitha duken njëlloj.

Por djemtë kur ulen trotuarit e shikojnë  
të gjithë duken njëlloj.

## PËR VËLLAIN

Vëllai im është pikë e vogël e horizontit  
që vrapon drejt meje.  
Unë vizatoj sytë e tij,  
ai mbledh manaferra,  
ai ndan çokollatën më katërsh.  
Unë vizatoj sytë e tij,  
ai zgjohe në mëngjes dhe më thotë:  
Motra! Sa i gëzuar jam,  
atë që lexova dje dhe s'e kuptova fare  
e pashë në ëndërr të qartë  
Unë vizatoj sytë e tij.  
Sytë e vëllait  
s'do t'i mbaroj së vizatuari kurrë.



## NË DURRËS

Kaloj në rrobaqepësi, tempuj, restorante,  
në rrugë mermeri e në rrugë sere  
njëherësh.

Si gjithë të tjerët hamendësoj e kujtoj  
ndonjë fakt.

Të vërtetat vetëm deti i di.  
Dhe ne do t'i dimë një ditë,  
atëherë kur deti të mësojë të flasë.



## NATYRË E QETË

Mendimi fillon nga lulja e bardhë  
dhe ftillohet tek lulja e kuqe.  
Kjo tufë me lule  
i ngjan dashurisë sime të heshtur,  
dashurisë sime të heshtur që çel.

Dhe shkrova  
për të thyer mitin se natyra e qetë  
është për syrin e piktorit.

## E THJESHTË

Ti je nisur drejt meje  
nëpërmjet sakrificës sate  
dhe unë po përgatitem të të pres  
nëpërmjet sakrificës sime.

## PENELOPA BESNIKE

Unë besoj në besnikërinë e Penelopës.  
Besoj.

Se edhe nëse me një  
nga të treqind e tetëmbëdhjetë  
pretendentët,

ajo ka shkuar,  
sigurisht ai më shumë  
me Odisenë ka ngjasuar.

Kështu, pra, Penelopë.

## E RE PËR EVËN

Nuk është e vërtetë.  
Eva nuk shkoi me djallin.  
Ajo deshi veç burrin e saj,  
burrin e saj, Adamin.

Ashtu si për çdo grua dolën fjalë.  
Kësaj s'i shpëtoi dot as Eva,  
megjithëse në botë ish gruaja e parë.



TREGIM PËR PUSIN E FËMIJËRISË  
DHE STËRGJYSHIN

«Vëllanë e vogël e hodhën në pus  
dhe ai ra në një botë tjetër»  
nga përrallat e gjyshe

Kushërinjtë bënë rrëmujë me një  
kaleidoskop.  
Stërgjyshi i ulur në hijen e fikut të lashtë.  
Në të vetmen dorë kish një shkop,  
dora tjetër në Jemen i ishte kalbur.

E harroi zoti, thosh një gjyshe nëntëdhjetë  
vjeç,  
defterët ku ish emri i tij minjtë i kanë ngrënë.  
Babagjyshi i harruar nga zoti ruante fikun  
dhe kushërinjtë qëllonte me dorë të rëndë.

Dëgjova përrallat e gjyshe sime të ditur  
për motrën a vëllanë e vogël që binte në një  
pus.  
Unë rrija mbi pus e shikoja magjira.  
Kushërinjtë çmendeshin pas kaleidoskopit,  
plot zhurmë.

E babagyshi me një mëngore të bardhë bosh  
e me një tjetër me dorë të lidhur krihte  
dhe dukej se e kish harruar dhe ai veten, i  
asnjë çikë vend për ndonjë rrudhë të re s'kish  
mustaqet  
shkreti,  
në faqe.

Dhe kushërinjtë i dinin përrallat e gjyshes  
sime.  
Tek lodra ime një ditë vere u mblodhën.  
Nuk ishim motra, nuk ishim vëllezër  
dhe unë isha kushërira më e vogël.

Pra duhej të bija në pus. Më hodhën.  
E dija që aty kish kutira magjie,  
dhe dyer botërash, dhe flokë shtrige,  
dhe gurë të vdekur, dhe xhinde jeshile.

Por këtë radhë dyer nuk m'u hapën,  
shtriganë dhe xhinde nuk m'u shfaqën.  
Kushërinjtë e mirë në çikrik litarin mblodhën,  
po ngjitesha me një gjë të vockël në dorë.

Një vath vajze kisha gjetur në pus,  
një vath të artë, ujë pikonte, veshur me  
lëmyshk.  
Ngadalë u afruam, ta dhamë, babagjysh.  
E more, ngrive. U trembëm. Klithe.

Mërmërite: njëqind beharë (kohë përralle).  
Ne e ndienim se po bënim një përrallë,  
ti përkëdhelje sendin e pusit me një dorë  
që qëllonte rëndë dhe me një krah pëllumbi  
të bardhë.



## DOJA TË ISHË NË SHTËPINË TIME

Jam në qytetin e fundit të hartës,  
shumë qytete larg shtëpisë.  
Eci kot nëpër rrugë.  
Në vitrina dyqanesh  
qeska me karamele me ngjyra.  
Këto karamele me ngjyra  
më kanë mbushur gojën  
e s'po mund dot t'i ha.  
Nuk po qaj. Nuk është punë lotësh.  
Një urban më ndalon para.  
Hipi në të.  
Udhëtoj vetëm një stacion, dhe zbres.

Në dorë kam tani qeskën bosh  
të karameleve me ngjyra.  
Jam një stacion urbane më afër  
horizontit të shtëpisë.